



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-086

Prishtinë, më 3 dhjetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 DHJETOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20 nëntor 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 nëntor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 20 nëntor 2012.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 6 dhjetor 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë,
5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë,
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014,
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
8. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Kryesia, me kërkesë të kryetarit të Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, z. Albin Kurti, e shtyu shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës për mbledhjen tjetër të radhës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me projektligjin e cekur më lart, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të japë mendim lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, të hartuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

2. Kërkohet nga Ministria për Financa që të bëjë verifikimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji.

3. Qeveria e Kosovës duhet ta paraqesë mendimin e vet me shkrim në afatin prej një muaji, nga dita e pranimit të projektligjit, së bashku me deklaratën për verifikimin e ndikimit buxhetor.

2. Procedimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me statutin e cekur më lart, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që ta shqyrtojë propozimin e Qeverisë së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e cekur më lart, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Autorizohet Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike që, në bashkëpunim me Drejtorinë e Prokurimit, të bëjë përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012.

2. Vlerësimin e ofertave e bënë Komisioni vlerësues, i përbërë nga anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

3. Pas përfundimit të procedurave, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike duhet ta njoftojë Kryesinë e Kuvendit për përzgjedhjen e Auditorit të Jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012.

4. *Njoftimi me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me amendamentet kushtetuese të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me njoftimin e lartshënuar, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion që t'i shqyrtojë amendamentet kushtetuese, të propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Kuvendit t'i paraqesë raportin me rekomandime.

5. *Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Austri*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputeteve: Teuta Sahatqija, Flora Brovina dhe Alma Lama, nga Grupi i Grave Deputete, për të marrë pjesë në punëtorinë "Fuqizimi i strukturave parlamentare për gratë deputete në regjionin e OSBE-së", e cila do të mbahet në Austri, më 9-12 dhjetor 2012.

2. Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për deputetet Teuta Sahatqija dhe Alma Lama do të mbulohen nga organizatori - OSBE-ja, ndërsa shpenzimet në tërësi për deputeten Flora Brovina, si dhe mëditjet shtesë për të lartshënuarat në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

6. *Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike*

Kryesia, propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 6 dhjetor 2012.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale